

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaTop®-129 Sunshine

LLAÇ ME BAZË ÇIMENTOJE PËR HIDROIZOLIM



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaTop®-129 Sunshine është llaç me 2 përbërës gati për përdorim dhe me modul të ulët elasticiteti. Përbëhet nga një pluhur me bazë çimentoje i modifikuar me polimere sintetike të posaçme dhe tym silici (silica fume), përmban agregate të përzgjedhura me grimca të imëta, aditivë dhe një emulsion që i jep fleksibilitet miksit. Mund të përforcohet me rrjetë fibrash qelqi rezistuese ndaj alkaleve për nënshtresat që do të hidroizolohen dhe që janë subjekt i sforcimit në përkulje.

PËRDORIMET

SikaTop®-129 Sunshine përdoret:

- Si veshje hidroizoluese e përshtatshme për kontakt të drejtpërdrejtë me ujin e pishinës
- Si veshje për mbrojtjen e sipërfaqes së betonit, për përmirësimin e qëndrueshmërisë
- Për hidroizolimimin dhe mbrojtjen e strukturave hidraulike si basenet, rezervuarët, pishinat, tubacionet prej betoni
- Si një veshje mbrojtëse fleksibël për strukturat prej betonarmeje, kundër efekteve të kripës për shkrirje akulli, cikleve ngrirje-shkrirje dhe dioksidit të karbonit
- Për hidroizolimimin dhe mbrojtjen e tarracave/ çative dhe pishinave relativisht të vogla, zonave rrethuese që janë të ekspozuara ndaj kushteve të motit (subjekt vetëm i qarkullimit këmbësor).

SikaTop®-129 Sunshine është i përshtatshëm për:

- Mbrojtje kundër hyrjes së ujit (Parimi 1, Metoda 1.3, EN 1504-9:2008). Krijon një veshje barrierë për dioksidin e karbonit.
- Kontroll të lagështisë (Parimi 2, Metoda 2.3, EN 1504-9:2008)
- Rritje të rezistencës (Parimi 8, Metoda 8.3, EN 1504-9:2008)

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Nivel i lartë hidroizolimi
- Përbërës në ambalazhe të gatshme
- Rezistencë ndaj sforcimit përkulëse të nënshtresës, nëse nuk ndiqen nga plasaritja e nënshtresës
- Përshkueshmëri nga avujt e ujit
- Ndërkapje shumë e mirë mbi shumë nënshtresësa si betoni, llaçet, gurët, tullat, etj.
- Papërshkueshmëri nga avujt e ujit
- Pa plasaritje nga tkurrja
- Aplikim i thjeshtë mbi mure vertikale dhe tavane

MIRATIME / STANDARDE

- Markë CE dhe Deklaratë Performance si produkt - veshje për mbrojtjen e sipërfaqes sipas EN 1504-2

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Përbërësi A: polimer i lëngshëm me aditivë Përbërësi B: çimento e modifikuar që përmban agregate dhe aditivë të përzgjedhur	
Ambalazhi	Përbërësi A	kovë 6,25 kg
	Përbërësi B	thes 25 kg
	Përbërësit A + B	njësi 31.25 kg

Paraqitja / Ngjyra	Përbërësi A: lëng i bardhë Përbërësi B: pluhur i bardhë Përzjerja: e bardhë
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të padëmtuar dhe të pahapur, në kushte të thata dhe të freskëta në temperatura midis +5°C dhe +35°C.
Përmasa maksimale e kokrrizës	$D_{max} = 0,5 \text{ mm}$
Deklarata e produktit	Markë CE dhe Deklaratë Performance si produkt - veshje për mbrojtjen e sipërfaqes së betonit sipas EN 1504-2:2004, bazuar në certifikatën e kontrollit të prodhimit në fabrikë të lëshuar nga organi i kontrollit të prodhimit në fabrikë dhe lloji i testimit.

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	0,8MPa	(EN 1542)
Reagimi ndaj zjarrit	NPD	
Rezistenca ndaj ciklit ngrirje-shkrirje dhe kripërave akullshkrirëse	$\geq 0,8 \text{ MPa}$	(EN 13487-1)
Përshkueshmëria e avujve të ujit	Kategoria I $S_D < 5 \text{ m}$ (i përshkueshëm nga avujt e ujit)	(EN ISO 7783)
Absorbueshmëria kapilare	$w < 0,1 \text{ kg/m}^2 \cdot \text{h}^{0,5}$	(EN 1062-3)
Depërtimi i ujit nën presion	Presioni i ushtruar 1,5 bar për 7 ditë	Rezultatet Pa depërtim
		EN 14891 A.7
Përshkueshmëria e dioksidit të karbonit	$S_D > 50 \text{ m}$	(EN 1062-6)

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes	Përbërësi A : Përbërësi B = 1 : 4 (pjesë për peshë)
Dendësia e llaçit të freskët	~ 2,0 kg/L
Konsumimi	Si udhëzim, ~ 2.0 kg/m ² / mm
Trashësia e shtresës	Trashësia max. e rekomanduar për veshje është 2mm. Për hidroizolim dhe mbrojtje betoni, trashësia totale e aplikimit duhet të jetë të paktën 4mm.
Temperatura e mjedisit	+8 °C min. / +30 °C max.
Temperatura e nënshtresës	+8 °C min. / +30 °C max.
Koha e punueshmërisë	~ 50 minuta (në +20°C)

UDHËZIME APLIKIMI

PAJISJET

SikaTop®-129 Sunshine duhet të përzihet mekanikisht me një mikser me veprim të detyruar (max. 500 rpm).

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Nënshtresa duhet të ketë strukturë të qëndrueshme dhe të jetë pa gjurmë ndotësish, grimca të lira dhe të shkrifëta, qumësht (kore çimentoje), vaj dhe graso, etj. Rezistenca e betonit ndaj tërheqjes "pull off" (e ndërkapjes në tërheqje) duhet të jetë $> 1,5 \text{ N/mm}^2$. Nënshtresa duhet të përgatitet me teknika të përshtatshme përgatitjeje mekanike, si uji me presion të lartë ose fryerje me rrymë rëre. Preferohen metoda pastrimi pa përplasje/vibrim. Largoni pluhurin nga nënshtresa p.sh. me fshësë thithëse. Betoni i dëmtuar, i shpëtëzuar ose i dobët duhet të riparohet me llaçet e përshtatshëm për riparime nga seria e produkteve Sika MonoTop® ose SikaRep®. Lagni paraprakisht sipërfaqen deri në saturim.

Sipërfaqja e lagur duhet të arrijë një paraqitje të errët mat, pa shkëlqim dhe pa pellg uji.

PËRZIERJA

Tundeni me kujdes Përbërësin A përpara përdorimit. Pastaj hidhni ~ ½ e Përbërësit A brenda një ene të pastër dhe të përshtatshme për përzierje dhe shtoni ngadalë Përbërësin B ndërsa jeni duke përzierë. Kur kjo përzierje të jetë bërë homogjene, shtoni sasinë e mbetur të Përbërësit A dhe përzieni plotësisht për të paktën 3-4 minuta, derisa të arrihet një miks përfundimtar pa kokrriza.

Mos shtoni ujë apo përbërës të tjerë brenda miksit! Çdo njësi ambalazhi duhet të përzihet plotësisht, për të shmangur shpërndarjen e gabuar të përmasave të agregateve që përmban pluhuri i përbërësit (B).

APLIKIMI

Aplikoni llaçin mbi nënshtresën e niveluar dhe që është përgatitur në mënyrë të njëtrajtshme. Aplikoni veshjen e parë me një mallë më dhëmbë (3x3 mm), duke ushtruar presion të fortë dhe të qëndrueshëm mbi nënshtresë për të arritur një trashësi të rregullt dhe konsistente. Mbi shtresën e parë të llaçit të freskët vendosni një rrjetë prej fibrash qelqi me rezistencë ndaj alkaleve (pesha >90g/m², hapësira rreth 5 mm), të prerë saktë, duke e vendosur plotësisht brenda llaçit me një mallë të sheshtë. Pasi të jetë ngurtësuar kjo shtresë e parë, aplikoni një shtresë të dytë SikaTop®-129 Sunshine me mallë të sheshtë, një herë vertikalisht dhe një herë horizontalisht. SikaTop®-129 Sunshine mund të spërkatet me pompë të përshtatshme llaçi të hollë.

Në rast aplikimi mbi nënshtresa të ngurta, si një veshje mbrojtëse për beton të armuar, pa synim hidroizolimim e tij, SikaTop®-129 Sunshine mund të aplikohet pa rrjetë fibrash qelqi në dy shtresa.

Mund të arrihet një finiturë e shkëlqyer sipërfaqjeje duke përdorur një shpatull të veshur me sfungjer sapo llaçi të fillojë të ngurtësohet. Një finiturë e lëmuar mund të arrihet gjithashtu nëse përdoret një mallë e sheshtë metalike dhe e lëmuar.

Për sa i përket fugave të mundshme të dyshemeve dhe zonave të tjera kritike (p.sh. ndërfaqja e sipërfaqeve vertikale dhe horizontale), rekomandohet përforsimi i shtresës hidroizoluese me Sika® Seal Tape F.

Trashësia max. e rekomaduar për veshje është 2mm. Për hidroizolim dhe mbrojtje betoni, trashësia totale e aplikimit duhet të jetë të paktën 4mm.

Mund të vendoset ngarkesë hidraulike mbi veshjen përfundimtare të aplikuar ~5-7 ditë pas përfundimit të saj, vazhdimisht dhe pa ndërprerje, që të parandalohet çngjyrosja dhe pabarazitë estetike gjatë tharjes. Mbani muret e lagështa nëse mbushja e pishinës kërkon më shumë se 1 ditë. Mos vendosni ngarkesë hidraulike nëse veshja nuk është ngurtësuar plotësisht.

Rekomandohet të mos kryhet asnjë trajtim kimik i ujit gjatë javës së parë të mbushjes së plotë të veshjes së pishinës me ujë. Pastaj vijoni me trajtimin e dezinfektimit të ujit gjatë javëve në vijim dhe derisa të stabilizohet pH. Megjithatë, pas rregullimit të pH, mund të filloni të kontrolloni dhe të rregulloni (nëse nevojitet) mineralizimin e ujit.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Heqja e mbetjeve të freskëta nga pajisja dhe veglat e aplikimit mund të bëhet me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

DOKUMENTA SHITESË

Për të shtuar qëndrueshmërinë e shtresës së SikaTop®-129 Sunshine të aplikuar mbi zonat me trafik (jo si veshje mbrojtëse e SikaTop®-129 Sunshine të zhytur brenda aplikimeve të pishinave), aplikoni veshjen e fundit të SikaTop®-129 Sunshine, pas tharjes, një veshje Sikagard® 790 All-in-One Protect, e cila nuk ndikon mbi estetikën e produktit. Shmangni aplikimin e materialit të tepërt ose grumbullimin në formë pellgu të Sikagard® All-in-One Protect mbi sipërfaqen e SikaTop®-129 Sunshine.

KUFIZIME

- Llaçi i freskët duhet të mbrohet nga shiu për të paktën 6 orë pas aplikimit.
- Shmangni aplikimin në dhe mbrojeni materialin e freskët të aplikuar nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe/ose era e fortë dhe shiu.
- Nënshtresa duhet të jetë e qëndrueshme dhe të ketë fuga zgjerimi të rregullta për të absorbuar të gjitha zhvendosjet strukturore që priten.
- Mos aplikoni shtresa llaçi mbi SikaTop®-129 Sunshine. Nëse nevojitet, nënshtresa duhet të nivelohet dhe të profilizohet përpara aplikimit të SikaTop®-129 Sunshine.
- SikaTop®-129 Sunshine nuk është certifikuar sipas EN 14891 për përdorim poshtë pllakave qeramike. Disa këshilla për trajtimin dhe mirëmbajtjen e pishinave:
- Përdorni vetëm produkte që janë krijuar posaçërisht për pishinat dhe ndiqni dozën e rekomanduar nga prodhuesi.
- Mos vendosni produkte të përqënduara (dezinfektues, rregullatorë pH) në kontakt të drejtpërdrejtë me veshjen. P.sh. mos i hidhni produktet mbi muret ose në fundin e pishinës.
- Trajtimi tepër i koncentruar kundër shokut mund të degradojë veshjen.
- Shmangni përdorimin e produktit në rast se përdoren sisteme elektrolite për trajtimin e ujit me bazë kripërash magnezi/potasiumi, të cilat mund të dëmtojnë veshjen.
- Mos përdorni sulfat bakri si trajtim kundër algave dhe acid hidroklorik për pastrimin e pishinës.
- Udhëzimi i përgjithshëm për trajtimin e duhur të pishinës është ruajtja e ekuilibrit kimik të ujit (pH rreth 7 me fortësi brenda 10-15°F).
- Në rastin e kontrollit automatik të pH, siguroni funksionimin normal të pajisjes. Në rast dështimi, hedhja me tepri e rregullatorit të pH mund të shkaktojë rënie të pH dhe demineralizim të ujit, duke shkaktuar degradim të veshjes.

- Si të gjitha veshjet e ngjashme, SikaTop®-129 Sunshine mund të jetë subjekt i zhvillimit të mikroorganizmave (alga, kërpudha, myk, etj.) që ndodh nganjëherë në formë pikash me ngjyra të ndryshme (kafe, gri, e gjelbër, etj.). Ky shumim i mikroorganizmave shkaktohet nga agjentë të jashtëm dhe për këtë ju nevojitet një trajtim i posaçëm (algacid, biocid, baktericid, etj.).
- Për pastrimin e veshjes ekzistuese mos përdorni veglat metalike (furça, shpatulla, etj.), pasi ka rrezik për depozitim grimcash, oksidim dhe ndryshk.
- Edhe kontakti i përkohshëm me substancat organike (p.sh. gjethet) ose dheu mund të njohtë veshjen.
- Sipërfaqja përfundimtare mund të ketë disa nuanca me ngjyrë më të zbardhur si pasojë e mënyrës së dhënies së finiturës. Por, kjo gjë nuk lidhet me cilësinë e produktit.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
SikaTop®-129 Sunshine
Gusht 2019, Botimi 02.01
020701010020000152

SikaTop-129Sunshine-sq-AL-(08-2019)-2-1.pdf

BUILDING TRUST

